



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPSTINA LIPJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të neneve 12 paragrafit 12.2 shkronja c), 16 dhe 17 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 04.06.2008, neneve 15 par.2 dhe 17 par. 5 dhe 6 të Ligjit për Transportin Rrugor Nr. 04/L-179, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 21/13 Qershor 2013 si dhe neneve 9 dhe 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 31. 02. 2019, pas shqyrtimit të propozimit të vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

RREGULLORE PËR TRANSPORTIN E RREGULLT URBANPERIFERIK TË UDHËTARËVE ME AUTOBUS

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i miratimit të kësaj Rregulloreje (në vazhdim të tekstit: Rregullore) është që Komuna në pajtim me dispozitat e Ligjit për Transportin Rrugor të realizojë përgjegjësitë për transportin e rregullt urban periferik të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit.

Neni 2 Objekti i rregullimit

Objekt i rregullimit i kësaj Rregulloreje është caktimi i linjave, pikënisjeve dhe pikarritjeve, vendndaljet e autobusëve, planin e nisjeve dhe caktimin e orareve të udhëtimit, kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë operatorët për ushtrimin e veprimtarisë të transportit të udhëtarëve, procedura për ndarjen e orareve të rrethit të udhëtimit në linja, revokimi i rendit të udhëtimit dhe obligimet për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Organizimi i transportit urbanperiferik

1. Transporti urban periferik i rregullt i udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës do të bëhet nga operatorët transportues sipas linjave dhe orareve të udhëtimit të përcaktuara me këtë Rregullore.

2. Transporti urbanperiferik i rregullt i udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës së Lipjanit do të bëhet çdo ditë të javës duke filluar prej orës 05:30 deri në orën 20:00 në linjat dhe oraret e përcaktuara me këtë Rregullore.

II. LINJAT PËR TRANSPORTIN URBAN PERIFERIK TË UDHËTARËVE

Neni 4

Relacioni i linjës, pikënisjet, pikëarritja dhe vendndaljet

Për transportin urban periferik të udhëtarëve me autobus përcaktohen linjat e qarkullimit të autobusëve, pikënisjet, vendndaljet dhe pikërritjet, si vijon:

Linja 1 - Relacioni : Lipjan -Magurë- Aeroport

Pikënisja	Pikëarritja
Stacioni i autobusëve	Aeroport

Vendndaljet në nisje:

1.Në rrugën "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", në rrugën "Lidhja e Prizrenit", rruga "Hajredin Bajrami", në fillim të rrugës "Ismet Asllani" te Qendra Korrektuese, Hallaq i Vogël, përballë Mullirit, Rufe i Ri afër shkollës fillore "Migjeni", Torinë te pompa e benzines "Denita", rruga për Dobrajë, Poturovc përballë Xhamisë, te rruga Ribari i Madh, Qylagë përballë shkollës, rruga për Blinajë, Magurë përballë udhëkryqit për Shalë, Magurë para Postës, Medvec afër Feronikelit, Vrellë afër shkollës fillore "Fehmi Agani", Aeroport.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" përballë shkollës "Vëllëzërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve.

Linja 2 - Relacioni : Vrellë e Magurës- Magurë-Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Vrellë e Magurës	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Vrellë afër Shtëpisë së Kulturës, Medvec, Magurë para postës, rruga për Shalë, rruga e Blinajës, Qylagë përballë shkollës, rruga Ribari i Madh, Poturovc përballë Xhamisë, rruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines Denita, Rufe i Ri afër shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë Mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" përballë shkollës "Vëllëzërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", përballë shkollës "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 3 - Relacioni: Leletiq- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Leletiq	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Leletiq, udhëkryqi për Aeroport, rruga e Blinajës, Qylagë përballë shkollës, rruga Ribar i Madh, Poturovc përballë xhamisë, rruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines Denita, Rufe i Ri afër shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami" rruga "Komandant Kumanova"përballë shkollës "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballëshkollës "Vëllezërit Frashëri" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi"shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani",rruga"Lidhja e Prizrenit"dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 4 - Relacioni : Blinajë- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Blinajë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Blinajë afër shkollës, Magurë rruga e Blinajës, Qylagë përballë shkollës, rruga Ribar i Madh, Poturovc përballë xhamisë, rruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines Denita, Rufe i Ri afër shkolles fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga " Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballëQendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi"shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani",rruga"Lidhja e Prizrenit"dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja5 - Relacioni : Teqe -Janjevë- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Teqe	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Teqe, JanjevëQarshija, "Metal Hollding", rruga për Akllap, Gushtericë e Epërme, Gushtericë e Ulët, Dobratin, udhëkryqi (Banullë) rruga " Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Komandant Kumanova" përballë shkollës "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi"përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi"shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga"Lidhja e Prizerenit", dhe rruga " Bajram Gashi" përballë Qendrës sportive.

Linja 6 - Relacioni : Akllap - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Akllap	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Akllap te shkolla, Gushtericë e Epërme, Gushtericë e Ulët, Dobratin, udhëkryqi (Banullë) rruga "Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Lidhja e Prizrenit" përballë shkollës "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" Shkolla e Mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Bajram Gashi" përballë Qendrës sportive.

Linja 7 - Relacioni : Gadime e Epërme- Gadime e Ulët- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Gadime e Epërme	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Gadime e Epërme afër Xhamisë, shkolla "Zenel Hajdini", Gadime e Ulët te shpella, rruga për Gllavicë, Marevc, Llugaxhi, rruga për Qallapek, rruga për Smallushë, afër pompës së benzinës "Banulla Petroll", udhëkryqi Banullë, afër fermës së pulave, rruga "Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Bajram Gashi" përballë Qendrës sportive.

Linja 8 - Relacioni : Shalë - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Shalë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Shalë afër Xhamisë, rruga për Bainsë, fshati Risinove, Fushticë e Ulët, Fushticë e Epërme, Mirenë, Leletiq, udhëkryqi Magurë Aeroport, rruga për Blinajë, Qylagë përballë shkollës fillore, rruga Ribar i Madh, Poturovc përballë Xhamisë, rruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines Denita, Rufc i Ri përballë shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 9 - Relacioni : Krojmir - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Krojmir	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Krojmir afër Shkollës fillore, Krojmir te mulliri, Shalë, rruga për Bincë, fshati Risinoc, Fushticë e Ulët, Fushticë e Epërme, Mirenë, Leletiq, udhëkryqi Magurë Aeroport, rruga për Blinajë, Qylagë përballë shkollës fillore, rruga Ribar i Madh, Poturovc përballë Xhamisë, rruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines Denita, Rufe i Ri përballë shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 10 - Relacioni : Zllakuqan- Ribar i Madh Kraishtë-Hallaq i Madh-Grackë e Vjetër Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Zllakuqan	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Zllakuqan, Ribar i Madh afër Xhamisë dhe përballë lapidarit "Xhavit Kozhani", Kraishtë afër xhamisë, te udhëkryqi i rrugës për Breg të Zi, Hallaq i Madh te shkolla fillore, Grackë e Vjetër përballë Qendrës Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami" rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", Stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 11 - Relacioni : Kraishtë -Ribar i Madh- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Kraishtë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Kraishtë afër xhamisë, Ribar i Madh përballë lapidarit "Xhavit Kozhani" përballë Xhamisë, rruga për Magurë, Poturovc te Xhamiarruga për Dobrajë, Torinë pompa e benzines

Denita, Rufc i Ri përballë shkolles fillore "Migjeni, Hallaq i Vogël përballë mulliri, te Qendra Korrektuese, rrethllotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 12 - Relacioni : Dobrajë e Vogël- Dobrajë e Madhe - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Dobrajë e Vogël	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Dobrajë e Vogël, Dobrajë e Madhe, Poturovc përballë shkollës fillore, Torinë pompa e benzines Denita, Rufc i Ri përballë shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", në rrugën "Lidhja e Prizrenit", dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 13 -Relacioni : Lluga - Dobrajë e Madhe - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Lluga	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Lluga, Dobrajë e Madhe, Poturovc përballë shkollës fillore, Torinë pompa e benzinës Denita, Rufc i Ri përballë shkolles fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Haradin Bajrami".

Linja 14- Relacioni : Sllovi - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Sllovi	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Sllovi te shkolla e re, shkolla e vjetër, Dobratin, te udhëkryqi Banullë, " afër fermës së pulave,në rrugën "Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi"përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani",rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga " Bajram Gashi" përballë Qendrës sportive.

Linja 15- Relacioni : Smallushë -Magjistrale- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Smallushë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Smallushë, magjistrerja Prishtinë - Ferizaj, afër pompës së benzines "Banulla Petroll", te udhëkryqi Banullë, afër fermës së pulave, rruga "Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi"përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani",shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani",rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga " Bajram Gashi" përballëqendrës sportive.

Linja 16- Relacioni : Gadime e Epërme - Babush - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Gadime e Epërme - Babush	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Gadime e Epërme afër xhamisë, te shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime eUlët te Shpella, lagja e Hashanëve, shkolla fillore Babush Gadime, Babush në magjistralen Prishtinë - Ferizaj, Llugaxhi,magjistrale rruga për Smallushë, afër pompës së benzines "Banulla Petroll", te udhëkryqi për Banullë, afër fermës së pulave, rruga "Skënderbeu" përballë parkingut të hekurudhës, rruga "Komandant Kumanova" shkolla

"Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi"përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi"shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Bajram Gashi" përballëQendrës sportive.

Linja 17 - Relacioni : Rubovc - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Rubovc	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Rubovc, afër Stacionit të trenit, te rruga për fshatin Kojskë, Lipjan rruga "Fehmi Agani" përballë Tori Market, rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" shkolla e mesme "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Fehmi Agani" përballë Tori Market.

Linja 18 - Relacioni : Grackë e Vogël - Topliqan- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Grackë e Vogël	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Grackë e Vogël, Topliqan te qeshmja, stacioni për Grackë të Vjetër, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla e mesme "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Hajredin Bajrami".

Linja 19 - Relacioni : Varigovc - Bregu i Zi- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Varigovc	Stacioni i autobusëve -

Vendndaljet në nisje:

Fshati Varigoc afër shkollës, Bregu i Zi, vendndalja rruga Magjistrale Lipjan Shtime, vendndalja Bujan, Grackë e Vogël, Jeta e Re, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Haradin Bajrami".

Linja 20 - Relacioni : Bujan -Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Bujan	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Bujan te shkolla e re, Magjistrale Lipjan Shtime, vendëndalja Bujan, Grackë e Vogël, Jeta e Re, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Haradin Bajrami".

Linja 21 - Relacioni : Lipjan - Konjuh

Pikënisja	Pikëarritja
Stacioni i autobusëve	Konjuh

Vendndaljet në nisje:

Stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi", shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" dhe Konjuh te shkolla.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet stacioni, rruga "Avdi Kelmendi" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve.

Linja 22 - Relacioni : Vrellë e Gadimës - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Vrellë e Gadimës	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Vrellë te shkolla fillore, rruga për Plitkoviq, Gadime e Epërme afër xhamisë, te Shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime e Ulët te Shpella.

Vendndaljet në kthim:

Gadime e Ulët te shpella, te shkolla fillore "Zenel Hajdini", Gadime e Epërme afër xhamisë, rruga për Plitkoviq, Fshati Vrellë te Shkolla Fillore.

Linja 23 - Relacioni : Kleqkë - Shalë

Pikënisja	Pikëarritja
Kleqkë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Kleqkë te shkolla, Shalë afër xhamisë, te shkolla Shalë.

Vendndaljet në kthim:

Shkolla Shalë, Shalë afër Xhamisë, Kleqkë te Shkolla.

Linja 24 - Relacioni: Gllanicë -Dobrajë e Madhe - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Gllanicë	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Fshati Gllanicë te shkolla, Dobrajë e Madhe lagja e "Zborcëve" përballë xhamisë, Poturofc përballë Shkollës fillore, Torinë pompa e benzines Denita, Rufc i Ri përballë shkollës fillore "Migjeni", Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami" rruga " Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi"përballëQendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve,rruga "Avdi Kelmendi" shkolla "Adem Gllavica" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit" dherruga "Hajredin Bajrami".

Linja 25 - Relacioni Ribar i Vogël - Rufc i Vjetër- Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Ribar i Vogël	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Ribar i Vogël te xhamia, Rufc i Ri te shkolla fillore "Migjeni", Rufc i Vjetër te varrezat,Hallaq i Vogël përballë mullirit, Qendra Korrektuese, rrethrotullimi Shtime Lipjan, rruga "Hajredin Bajrami", rruga " Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja, stacioni i autobusëve,rruga "Avdi Kelmendi",shkolla "Adem Gllavica" përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani"rruga "Lidhja e Prizrenit" dhe rruga "Haradin Bajrami".

Linja 26 - Relacioni: Glllogofc - Lipjan

Pikënisja	Pikëarritja
Glllogofc	Stacioni i autobusëve

Vendndaljet në nisje:

Glllogofc afër xhamisë, Lipjan rruga "Fehmi Agani" përballë Tori Market,rruga "Komandant Kumanova" shkolla "Vëllezërit Frashëri", rruga "Avdi Kelmendi" përballëQendrësKulturore "Tahir Sinani" shkolla "Adem Gllavica", stacioni i autobusëve Lipjan.

Vendndaljet në kthim:

Si në nisje, me përjashtim në qytet do të shfrytëzohet vendndalja stacioni i autobusëve, rruga "Avdi Kelmendi"shkolla "Adem Gllavica", përballë Qendrës Kulturore "Tahir Sinani", rruga "Lidhja e Prizrenit", dhe rruga "Fehmi Agani" përballë Tori Market.

Neni 5

Plani i nisjeve dhe caktimi i orareve të rendeve të udhëtimit

1. Drejtorati i Shërbimeve Publike, për përmbushjen e nevojave të qytetarëve për transport me autobus, në afat prej dy muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje përgatitë planin e numrit të nisjeve dhe orareve të nisjeve të rendeve të udhëtimit për secilën linjë të përcaktuar me këtë Rregullore.
2. Plani i nisjeve mund të plotësohet në bazë të kërkesave të institucioneve dhe qytetarëve për plotësimin e nevojave për transport.
3. Kërkesat për plotësimin e planit të nisjeve i parashtrohen Drejtoratit të Shërbimeve Publike një herë brenda vitit në periodën prej 1-30 prill.
4. Plani i nisjeve dhe orareve të rendeve të udhëtimit nga paragrafët paraprak miratohet me vendim të Kryetarit të Komunës.

III. KUSHTET PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË

Neni 6

Kushtet për transportuesit

1. Transportin urban periferik të udhëtarëve me autobus në territorin e Komunës mund ta bëjnë Operatorët transportues të regjistruar për kryerjen e veprimtarisë së transportit të udhëtarëve (në vazhdim të tekstit – transportuesit), të cilët i plotësojnë kushtet e përcaktuara me ligj, akte nënligjore dhe me këtë Rregullore.
2. Transportuesit për kryerjen e transportit urbanperiferik të udhëtarëve duhet të posedojnë autobus përkatës dhe staf profesional për ushtrimin e veprimtarisë.
3. Në vendet e thella ku numri i udhëtarëve është më i vogël operatorët e transportit urbanperiferik mund të përdorin edhe minibuset me 17+1 ulëse për transportin e udhëtarëve.

Neni 7

Autobusët

Autobusët me të cilët kryhet transporti i udhëtarëve, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me dispozita për pjesëmarrje në komunikacion, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Në pjesën anësore të vënë emrin e operatorit transportues të udhëtarëve;
2. Të posedojnë sistemin e nxehjes dhe ajrosjes;
3. Të mbajnë dritaret e pastra dhe pa reklama;
4. Në brendi të autobusit në vend të dukshëm të jetë i shkruar mbishkrimi - Ndalohet pirja e duhanit;

5. Të kenë dyer të veçanta për hyrje dhe dalje të udhëtarëve dhe të posedojnë mjetin e paraparë për thyerjen e xhamave në rast rreziku i cili duhet të jetë i vendosur në vend me mbishkrimin: “ Për përdorim në rast rreziku”.

6. Të mos marrë udhëtarë në autobus më shumë se posedon ulëse.

IV.PROCEDURA PËR NDARJEN E ORAREVE TË RENDEVE TË UDHËTIMIT

Neni 8

Ndarja e rendeve të udhëtimit sipas orareve

1.Ndarja e rendeve të udhëtimit sipas orareve të përcaktuara me planin e nisjeve dhe caktimin e orareve të udhëtimit do të bëhet në bazë të shpalljes publike të cilën e shpallë dhe e zbaton Drejtorati i Shërbimeve Publike në pajtim me këtë Rregullore.

2. Shpallja publike nga paragrafi paraprak do të bëhetbrenda afatit prej 6 muajve nga dita e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje.

3. Shpallja publike për ndarjen e rendeve të udhëtimit sipas orareve të nisjeve në kuadër të linjave përkatëse do të shpallet në çdo 3 vite.

4. Rendi i udhëtimit vlen tri vite.

Neni 9

Kushtet dhe kriteret për aplikim

1. Transportuesit të cilët aplikojnë sipas shpalljes publike për ndarjen e orareve sipas nisjeve të përcaktuara në linjat përkatëse, duhet të prezantojnë dokumentacionin, si vijon:

1.1 Aplikacionin e plotësuar me të dhënat e kërkuara,

1.2 Certifikatën e regjistrimit të biznesit,

1.3 Licencën për ushtrimin e veprimtarisë të transportit rrugor meautobus,

1.4 Certifikatat e qarkullimit të autobusëve që operatori i ka në pronësi,

1.5 Certifikatën e autobusit – për çdo relacion një autobus,

1.6Kontratat e punës dhe patent shoferët e drejtuesëve të autobusëve – për çdo relacion prej 1 – 30 km një (1) shofer,

1.7 Dëshminë e lëshuar nga Gjykata se operatori nuk ka pengesa ligjore të zhvillojë veprimtarinë në lëmin e transportit.

Neni 10

Shpallja publike

1.Shpalljen publike e zbaton Komisioni prej 5 anëtarëve i emëruar nga Kryetari i Komunës.

2. Shpallja publike do të publikohet së paku në një gazetë të përditshme ditore dhe në faqen elektronike të Komunës.

3. Shpallja publike duhet të përmbajë emërtimin e linjës, relacionin, pikënisjet, pikëarritjet, kohën e nisjes, kushtet e aplikimit të transportuesëve, dokumentacionin i cili duhet të bashkangjitet aplikacionit, vendi dhe koha e dorëzimit të aplikacioneve dhe afati i konkurimit.

4. Komisioni pas përfundimit të shpalljes publike shqyrton aplikacionet dhe dokumentacionin e bashkangjitur.

5. Për transportuesit të cilët i plotësojnë kushtet e aplikimit sipas shpalljes publike, Komisioni harton propozimet konkrete për ndarjen e rrethit të udhëtimit sipas nisjeve të caktuara në kuadër të linjave përkatëse dhe ia dërgon për miratim dhe marrje të vendimit Drejtorit të Drejtoratit për Shërbimeve Publike.

Neni 11

Vendimi për ndarjen e orarit të udhëtimit

1. Në propozim të Komisionit, Drejtori i Drejtoratit për Shërbime Publike merr Vendim me të cilin operatorit të caktuar i ndahen rendet e udhëtimit sipas nisjeve të caktuara në kuadër të linjave përkatëse.

2. Në bazë të vendimit nga paragrafi paraprak do të përpilohen rendet përkatëse të udhëtimit të cilat duhet të përmbajnë shënimet e përcaktuara me dispozita ligjore.

V.OBLIGIMET E TRANSPORTUESËVE

Neni 12

Obligimi për pajisjen dhe mirëmbajtjen e autobusëve

1. Transportuesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së transportit të udhëtarëve janë të obliguar të përdorin autobus në pajtim të dispozitave ligjore dhe të nenit 6 të kësaj Rregulloreje.

2. Shoferi i autobusit, gjatë ushtrimit të transportit me autobus duhet të posedojë dokumentacionin : lejen e qarkullimit për autobus, patent shoferin për drejtimin e autobusit, kontratën e punës dhe rendin e vërtetuar të udhëtimit për linjën përkatëse.

Neni 13

Rendi i udhëtimit

1. Rendi i udhëtimit për transportin urbanperiferik të udhëtarëve përmban: emërtimin e transportuesit dhe selinë, emërtimin e linjës dhe relacionin, pikënisjet dhe pikëarritjet e autobusëve me radhitjen e vendndaljeve, kohën e nisjes nga stacioni i nisjes dhe kohën e arritjes në çdo vendndalje dhe në stacionin e pikëarritjes dhe afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.

2. Rendi i udhëtimit për orarin e fituar për transportin e udhëtarëve në pajtim të procedurave të përcaktuara me këtë Rregullore vlenë tri vite.

3. Rendi i udhëtimit duhet të përmbajë një nisje dhe një kthim.

4. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet e as të jepet me qira.

5. Rendi i udhëtimit duhet të jetë në pajtim me vendimin mbi ndarjen e orareve në linjat e caktuara.

6. Emri i transportuesit i shënuar në rendin e udhëtimit duhet të jetë i njëjti me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe dokumenteve tjera përcjellëse të autobusit.

7. Për rendin e fituar, operatori me rastin e tërheqjes së tij duhet të sjellë dëshminë mbi pagesën me shumë prej 30 € për çdo rend të udhëtimit.

8. Komuna nuk ka të drejtën e vazhdimit të rendeve ministrore.

Neni 14

Revokimi i rendit të udhëtimit

1. Transportuesit i revokohet rendi i udhëtimit nga Drejtoria e Shërbimeve Publike në bazë të raporteve të inspektorit komunal të transportit rrugor për rastet kur transportuesi:

1.1. vepron në kundërshtim me legjislacionin në fuqi me të cilin rregullohet transporti rrugor i udhëtarëve me autobus;

1.2. Brenda një muaji kalendarik nuk e mban tri herë rendin e udhëtimit (nisjen apo kthimin),

1.3. Brenda periudhës së vlefshmërisë së rendit të udhëtimit nuk mban dymbëdhjetë herë rendin e udhëtimit,

1.4. Bën tjetërsimin apo huazimin e rendit të udhëtimit,

1.5. Nisjet e caktuara në rendin e udhëtimit nuk i mbanë me autobus në pronësi të tij,

1.6. Ka pesë vërejtje me shkrim për të njëjtin rend të udhëtimit nga Inspektori komunal i transportit rrugor.

2. Transportuesit të cilit i revokohet rendi i udhëtimit sipas paragrafit 1 të këtij neni apo humb atë në ndonjë rrethanë tjetër ligjore nuk ka të drejtë të aplikojë për të njëjtin rend të udhëtimit dy vjet.

Neni 15

Vendimi për revokimin e rendeve të udhëtimit

1. Vendimet për revokimin e rendeve të udhëtimit i nxjerr Drejtoria e Shërbimeve Publike për rastet e përcaktuara në nenin paraprak në bazë të raporteve të inspektorit komunal të transportit rrugor.

2. Transportuesi i pakënaqur me vendimin mbi revokimin e rendit të udhëtimit ka të drejtë ankese në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Neni 16

Procedura për ndarjen e rrendeve të revokuara të udhëtimit

Drejtorati i Shërbimeve Publike, në bazë të vendimeve të plotfuqishme mbi revokimin e rrendeve të udhëtimit, do të bëjë ndarjen e rrendeve të revokuara të udhëtimit sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje të parapara në Kapitullin IV - të - Ndarja e orareve të rrendeve të udhëtimit.

VI. OBLIGIMET E ORGANEVE DHE MBIKËQYRJA INSPEKTIVE

Neni 17

Obligimet e organeve komunale

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdeset Drejtorati për Shërbime Publike dhe Drejtorati i Inspektoratit – Inspektorët komunal të transportit rrugor.

Neni 18

Mbikëqyrja inspektive

1. Punët e inspektimit për transportin rrugor brenda territorit të komunës i bënë Inspektori komunal i transportit rrugor në pajtim me Ligjin për Transportin Rrugor dhe me këtë Rregullore.

2. Në rastet kur Inspektori i transportit rrugor, gjatë inspektimit konstaton parregullsi, ndaj operatorëve të transportit do të ndërmarrë masat e parapara me dispozitat e Ligjit për Transportin Rrugor.

VII. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 19

Hyrja në fuqi

1. Kjo rregullore hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit web faqen e Komunës.

2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja për transportin e rregullt urbano-periferik të udhëtarëve me autobus 15Nr.344-4287 e datës 12.03.2013.

15Nr. 011 - 7239

Lipjan, më 31. 01. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

